

Njohuritë e infermierëve rreth të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor-terciar (QKUK)

Hyda Verda¹; Bytyqi Albina¹

Kolegji Heimerer¹

Hyrje: Të drejtat e pacientit janë përcaktuar si rregulla të sjelljes midis njerëzve që përfitojnë nga shërbimet shëndetësore, institucionet dhe personeli që i japin ato. Këto të drejta kanë të bëjnë me rrethana të veçanta në jetën e njeriut, dhe gjithashtu përcaktohen si të drejtat e njeriut të gjeneratës së tretë dhe mbulon zbatimin e të drejtave të pacientëve ku përfshihet: të respektohen si qenie njerëzore, të marrin shërbimin shëndetësorë në një nivel të lartë, të marrin informacion, të marrin konfirmimin për proceset mjekësore, privatësinë dhe respektin për jetën private gjatë marrjes së kujdesit dhe vazhdimësinë e trajtimit (Selen Ozakar Akca,2014).

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të bënim vlerësimin e infermierëve rreth njohurive të tyre mbi të drejtat e pacientëve në Kujdesin Shëndetësor Terciar në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK).

Metodologjia: Metoda e cila është përdorur në këtë hulumtim është i llojit kuantitativ e cila paraqet vlerësimin e njohurive të infermierëve rreth të drejtave të pacientit në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës konkretisht (SHSKUK) në Prishtinë. Nga 105 pjesëmarrës që ishin në këtë hulumtim 35.2% ishin të gjinisë meshkuj dhe 64.8% ishin të gjinisë femër. Instrumenti i cili është përdorur është “Knowledge of nurses regarding patient rights” nga autorët Selen Ozakar Akcal, Yeliz Yelen Akpınar, Turgay Habbani (2014), (Selen, et al 2014). Instrumenti ka 3 pyetje Demografike dhe 26 pyetje mbi të drejtat e pacientit.

Rezultatet: Nga ky hulumtim rezulton se 69% e infermierëve janë pajtuar plotësisht se pacientët duhet të marrin shërbime shëndetësore pa dallim komuniteti dhe 55% e infermierëve janë pajtuar plotësisht se pacientët kanë të drejtë dhe duhet të marrin shërbimet e kujdesit shëndetësor në një mjedis të sigurt.

Konkludimet: Nga rezultatet e marra nga ky hulumtim në (SHSKUK)-Prishtinë, infermierët kanë njohuri mbi të drejtat e pacientëve. Gjithashtu duke u bazuar në këtë hulumtim infermierët duhet të vazhdojnë të mbajnë trajnime për shmangien e problemeve në aspektin e së drejtës së pacientit.

Fjalët kyçe: e drejta e pacientit, infermierët, njohuritë e infermierëve.